



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

NR. 2 DATË 18.01.2013

PËR

**LEJE INFRASTRUKTURE, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “QAFËZEZË” ME
INVESTITOR SHOQËRINË “ÇAUSHI ENERGJI” sh.p.k, NË KOMUNËN MOLLAS,
QARKU KORÇË**

Në mbështetje të nenit 8, nenit 8/1 dhe nenit 78 të Ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, nenit 12 pika 1, gërma “c” e Vendimit nr. 502, datë 13.07.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, e ndryshuar, Vendimit nr. 87 datë 07.02.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, Këshilli Kombëtar i Territorit

V E N D O S I :

1. Të miratohet leja e infrastrukturës, për ndërtimin e hidrocentralit “Qafëzezë” me investitor shoqërinë “Çaushi Energji” sh.p.k, në komunën Mollas, qarku Korçë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

SALI BERISHA


ZËVENDËS KRYETARI KKT
SOKOL OLLDASHI



MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

SEKRETARE E KKT

KREUZA LEKA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

